



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 21.05.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, Përfundimit nr. 06-31800-3/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt: 07.05.2015, si dhe në harmoni me rekomandimin e Komisionit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të dt: 19.05.2015, për përkrahjen financiare të OJQ "QTV" – Ansambli i Valleve të Qytetit për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e gardërobës së valltarëve, me dt: 21.05.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e OJQ "QTV" – Ansambli i Valleve të Qytetit të Gjakovës nr.10-400-16259 e dt: 26.02.2015, për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të këtij Ansambli për blerjen e gardërobës së valltarëve, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 2,000.00 € .

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 2,000.00€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e OJQ "QTV" – Ansambli i Valleve të Qytetit nr. 1401000000900727 - Banka Ekonomike .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Memli Doli, koreograf i OJQ "QTV"
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila